




Republika e Kosovës



Kuvendi Komunal Gjiilan

Njësia e Prokurimit

Gjiilan me datë: 08.08.2019

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Gjiilanit, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit mbi Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 8 (paragrafi 8.1.2) të Rregullës për Parashtrimin e Ankesave të publikuar nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas kërkesës për ri-shqyrtim të datës 30.07.2019, të parashtruar nga *Grupi i Operatorëve Ekonomik “EL-Bau “SH.P.K & N.N.T. “Eing Com “; “Vemor “SHPK* lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: *“Pastrimi i rrugëve, trotuareve, mirëmbajtja e parqeve dhe hapsirave gjebëruese” me Nr. të Prok: GI 651-18-045-2-2-1* nxjerr:

V E N D I M

Refuzohet kërkesa për ri-shqyrtim e *Grupit të Operatorëve Ekonomik “EL-Bau “SH.P.K & N.N.T. “Eing Com “; “Vemor “SHPK* e dt. 30.07.2019 lidhur me aktivitetin e prokurimit *“Pastrimi i rrugëve, trotuareve, mirëmbajtja e parqeve dhe hapsirave gjebëruese” me Nr. të Prok: GI 651-18-045-2-2-1* kundër Njoftimit mbi Vendimin e AK për dhënie të kontratës, i datës 26.07.2019 të publikuar në platformën e prokurimit elektronik.

1. **AK vendos të vazhdoj** sipas Njoftimi mbi vendimin e AK për dhënie të kontratës të publikuar me datën 26.07.2019.
2. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të publikohet për të gjitha palët në platformën elektronike në adresën : <http://e-prokurimi.rks-gov.net>

A r s y e t i m

Grupi i Operatorëve Ekonomik “EL-Bau “SH.P.K & N.N.T. “Eing Com “; “Vemor “SHPK me datë **30.07.2019**, ka parashtruar kërkesën për ri-shqyrtim, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: *“Pastrimi i rrugëve, trotuareve, mirëmbajtja e parqeve dhe hapsirave gjebëruese” me Nr. të Prok: GI 651-18-045-2-2-1*. Autoriteti Kontraktues me datën 08.08.2019 ka shqyrtuar kërkesën në fjalë si më poshtë:

Autoriteti Kontraktues pas analizimit dhe shqyrtimit të pikave të cilat janë kontestuar nga Operatori Ekonomik ka konstatuar se pretendimet ankimore nuk qëndrojnë pasi që:

Gjatë ri-vlerësimit dhe krahasimit të ofertave AK ka konstatuar se ofertës tuaj i mungon marrëveshja për shfrytëzimin e disa makinerive me Plasteline Vemor dhe për këtë arsye oferta juaj është eliminuar.

Zyrtari Përgjegjës i prokurimit bazuar në ato që u thanë më lart ka vendosur si në dispozitiv .

Këshilla juridike:

Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankesë pranë OSHP-së . Ankesa pranë OSHP-së duhet të dorëzohet brenda 10 (dhjete) diteve pas pranimi të këtij vendimi.

Kopje: Operatorit Ekonomik;
Zyrës së Kryetarit të Komunës;
Te gjitha palëve të interesuara;
Arkivit të Komunës.

Izet Kurteshi

U.D. Menaxher i Prokurimit

